



## Anët e Horizontit

Në këtë figurë janë të paraqitura Anët e Horizontit .

Anët kryesore të horizontit janë : **Veriu, Jugu, Lindja dhe Perëndimi.**

### Veriu

Veriu është pika e horizontit që është përkundrajt jugut, drejtimi në të kundërtën e jugut, ana që është në të majtë kur kthehemi me fytyrë nga lind dielli.

### Jugu

Pika e horizontit që është përkundrajt veriut; drejtimi në të kundërt të veriut, ana që është në të djathtë kur kthehemi me fytyrë nga lind dielli.

### Lindja

Pika e horizontit nga lind dielli; ana që është në të djathtë kur kthehemi me fytyrë nga veriu, drejtimi i përkundërt me perëndimin.

### Perëndimi

Pika e horizontit nga perëndon dielli, ana që është në të majtë kur kthehemi me fytyrë nga veriu, drejtimi i përkundërt me lindjen.